



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 01
Prishtinë, më 21 mars 2010, në orën 10: 30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Bali Muharremaj, Muhamet Mustafa dhe Albert Kinolli.

Të pranishëm: Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - koordinatorë, Musa Rudaku – zyrtar i fushës së ekonomisë dhe të financave, KIPRED (stafi mbështetës) - Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Arta Demolli – praktikante dhe Jusuf Zejna –KDI.

Mbledhjen e kryesoi Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Konstituimi i Komisionit

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen.

Kryesuesi - Tha se kjo mbledhje e Komisionit ka karakter konstituiv. Fushëveprimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, veçanërisht ka të bëjë me shqyrtimin e të dhënave të auditimit, e në veçanti me të dhënat nga Zyra e Auditorit Përgjithshëm. Nga puna e këtij komisioni varet kualiteti i raportit, i cili do t'i prezantohet seancës së Kuvendit.

Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare. Po ashtu, në raste të veçanta, Komisioni do të angazhojë ekspertë të jashtëm.

Propozoj që mbledhja e radhës të përshpejtohet, sepse janë dy çështje të ngutshme që duhet shqyrtuar në Komision: *çështja e parë ka të bëjë me përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010 dhe çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës buxhetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.*

Propozoj që mbledhja e Komisionit, për këto dy çështje, të mbahet ditën e mërkurë, më 23 mars 2011, në orën 10:00, ndërsa për takimet e rregullta do të vendoset varësisht nga propozimet e anëtarëve të Komisionit.

Murselj Haljilji – Propozoi që mbledhjet e Komisionit, nëse mbahen të hënën, të jenë në orën 10:00, por nëse Komisioni vendos që mbledhjet të mbahen të martave dhe të mërkurave, atëherë të jenë në orën 13:00.

Armend Zemaj- Tha se duhet të definohen saktë kompetencat e këtij komisioni me Komisionin për Buxhet dhe Financa. Komisioni duhet të fillojë me mbledhjet e rregullta, sepse raportet veç kanë filluar të procedohen në Kuvend. Për orarin e mbajtjes së mbledhjeve, ai ishte i mendimit se e hëna dhe marta janë ditë më të përshtatshme, sepse çështjet mund të procedohen më shpejt në Kryesinë e Kuvendit.

Albert Kinolli – Tha se agjenda e punës së këtij komisioni duhet të përshtatet me agjendën e Komisioneve të tjera, sepse disa deputetë janë anëtarë edhe në (së paku) tre komisione të tjera.

Ramiz Lladrovci – Tha se mandati i deputetit është prioritet para të gjitha angazhimeve të tjera. Deputetët e angazhuar në disa komisione, njërin nga komisionet e kanë prioritet dhe deputeti vendos se në cilin Komision do të marrë pjesë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nxori këtë

Përfundim

1. *Mbledhja e radhës e Komisionit mbahet ditën e mërkurë, më 23 mars 2011, në orën 13:00.*
2. *Mbledhjet e rregullta të Komisionit mbahen ditën e martë në orën 13:00.*
3. *Materiali për mbledhjen e radhës (e mërkurë, më 23 mars 2011, në orën 13:00) ju dorëzua anëtarëve të Komisionit.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Ali Sadriu